39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

**Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

**Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

**Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.



V.B

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose vendim nga gjyqi;

b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.



V.B

# PJESA III E KONTRATES Kushtet E Veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|---|---|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe |
| Personeli | 9 | Personeli kyç i identifikuar ne kete projket nga OE për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin: |
| | | 1. Lulzim Muharremi – Menaxher i projektit<br>2. Veton Pira – Udhëheqës i punishtes<br>3. Tahir Jakup – Inxhinier i Hidroteknikës<br>4. Gezim Halili – Inxhinier i Gjeodezis<br>5. Ardita Vllasaliu – Inxhinier i Komunikacionit<br><br>Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit. |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shume e sigurisë së ekzekutimit është 151,462.57euro per 170 ditë pune |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite. |
| Programi | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. |
| | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është 20 ditë |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të jetë 10.12.2019 |
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 140 ditë pune. |
| Dëmet e likuiduara | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.<br><br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës. |
| Regjistri i punës | 20.1 | Në vend punishte duhet te mbahet ditari dhe libri ndërtimor. |



V.B

| | | |
|---|---|---|
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit është Lahudim Myrtaj - inxh.i diplomuar; e-mail: lahudim.myrtaj@rks-gov.net,; nr. tel 044-136-613; Pozitën: Menaxher Rajonal-Gjilan; Departamentit/ Divizioni /Drejtoria: DMRR |
| Parapagimi | 26.1 | Ministria e Infrastrukturës do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit në baze të Ligjit 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2019 Neni 13 pika 4 nga data e nga data e caktuar nga Projket Menaxheri kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.<br><br>Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.<br><br>Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës. |
| Mbajtja e Parasë | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: 10% për cdo pagesë deri në përfundimin e punimeve.<br><br>Parat e mbajtura paguhen me sjelljen e Garancionit bankar në vlerën prej 10 % në afat prej 24 muaj (afati i përfundimit të periudhës së defekteve). |
| Shkaqet për kompensim | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve do të jetë 24 muaj. Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të puneve. |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e punëve, është vlera e punëve të kryera të pranueshme.<br><br>Nëse me fajin e OE vjen deri te shkëputja e kontratës atëherë me marrëveshje te palëve automatikisht shkëputet kontrata dhe pasojnë dënimet për OE si: nuk paguhen mjete nga Ministria e Infrastrultures për punët e pakryera dhe llogariten demet e shkaktuara për moskryerjen dhe zhegitjen e punimeve qe i paguan pune kryesi dhe automatikisht i konfiskohet sigurimi i ekzekutimit shuma 10% e vlerës totale te kontratës në Ministria e Infrastruktures dhe Transportit. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata. |



V.B

| | | |
|---|---|---|
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë |



V.B

# Aneks 1: SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

**Përmbajtja :**


I. Kërkesat e Përgjithshme

II. Përshkrimi i punëve me kushtet teknike

III. Pjesa Grafike (pjesë nga projekti )

IV. Pajisjet e obligueshme

V. Stafi i Obligueshëm

VI. Paramasa


**Prishtinë,2019**



V.B

HYRJE:

Në këto specifikime epen kërkesat teknike per realizimin e "Projektit zbatues për Sanimin e rrëshqitzës në Rrugën Hani i Elezit-Gorancë".

Projekti përmbanë të dhënat e nevojshme për zbatimin e tij në teren .Kontraktuesi është i obliguar që para fillimit të punimeve ti verifikoj të dhënat në projekt . Nëse nga kontrakuesi konstatohet ndonjë gabim ose mospërputhje në projekt , ai do ta informoj Menaxherin e projektit .

- Nëse mangësit në projekt janë të nivelit të ulët ,azhornimi do të bëhëhet nga kontraktuesi me miratimin e menaxherit të projektit.Për mangësi të cilat mund të ndikojnë në stabilitetin e strukturës duhet të informohet Punëdhnësi dhe në raste të veçanta edhe projektuesi i cili do të ep sqarimet e novojshme ose do ta plotësoj projektin .
- Specifikimet teknike janë përpiluar në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe tek të gjithë operatorët ekonomik të interesuar.
- Specifikimet teknike përshkruajnë, në mënyre jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme siq janë: sigurimi i kualitetit, përmbushja , terminologjia, kërkesat e projektit , dimensionet , testimi , metodat e testimit , siguria e komunikacionit dhe mjedisit dhe kushtet teknike për zhvillimin punimeve.

QËLLIMI:

Këto specifikime teknike kanë për qëllim Sanimin e rrëshqitzës në rrugën Hani i Elezit –Gorancë sipas projektit kryesor të hartuar nga kompania projektuese " 3D PROJECT " – Prishtinë. Sigurimi i kualitetit të punimeve do të bëhet sipas "Standardeve për rrugë dhe Ura " – viti 2004, të miratuara nga MTPT .

Testimet e materialëve dhe cilësisë së punimeve nga betoni duhet të bëhen , konformë Normave Europiane (EUROCOD) AASHTO dhe CNR dhe përshkrimeve të punëve me kushtet teknike të dhëna në projektin zbatues për "Sanimin e rrëshqitzës në Rrugën Hani i Elezit-Gorancë".

Sigurimin e kualitetit të materialeve dhe cilësisë së punimeve mund të bëhen edhe sipas Normave dhe standardeve teknike Kroate (Libri 1-6).

Kërkesat teknike te përcaktuara ne këto specifikime janë te detyrueshme për kontraktuesin e punimeve dhe menaxherin e projektit .

I : Kërkesat e Përgjithshme

1. Kontrolli i kualitetit

Brenda 21 ditë nga Pranimi i Letrës së Pranimit, Kontraktori duhet ti ofroj Menaxherit të Projektit-Inxhinierit ,Planin gjithëpërfshirës të kualitetit .

Plani i kualitetit duhet të tregoj se si Kontraktori do të implementoj kontrollin e kualitetit në Vendpunishte në mënyrë që të garantoj Punëdhënësit se të gjitha punët do të zhvillohen sipas kërkesave të Kontratës dhe do të arrihen standardet e kualitetit.

Plani i kualitetit do të përshkruaj në mënyrë precize se si do të kryhen të gjitha fazat e punëve (paisja, metodat, organizimi i fuqisë punëtore), kush do të jetë përgjegjës për këtë (të dhënat personale të inxhinierëve) dhe si kontrolli i brendshëm do të organizohet për të garantuar kualitetin e domosdoshëm të punëve. Në veqanti, ekipi i pavarur i kontrollit duhet të kontrolloj të gjitha dokumentet e lëshuara nga Kontraktori. Verifikimi i kontrollit duhet qartë të shfaqet në dokumente. Inxhinieri do të lejohet të vazhdoj me kontrollin e jashtëm të skemave të kualitetit, kurdo që e gjykon të domosdoshme.



V.B

Plani i kualitetit duhet të përfshijë detajet e procedurave të aprovuara, pikave të mbajtuar dhe pikave dëshmuese. Këto duhet të pajtohen me Inxhinierin.(Organin Mbikqyrës) .

Kushtet teknike dhe kërkesat tjera të përcaktuara në këto specifikime janë të detyrueshme për Kontraktuesin e punimeve dhe Menaxherin e projektit .

1.1 Materiali

- Materiali për ekzekutimin e punimeve duhet ti përgjigjet standardeve në fuqi si dhe rregullave teknike dhe se furnizimi duhet të bëhet nga kompanitë e licencuara në vend.

Kualitetin e materialit i cili përdoret, si dhe kualitetin e prodhimeve tjera të gatshme ekzekutuesi e dëshmon me ateste të shqyrtuara nga institucionet përkatëse.

Atestet dhe rezultatet e shqyrtimeve, ekzekutuesi ia dorëzon organit mbikqyrës përmes ditarit të punës.

Shpenzimet e dëshmisë së kualitetit të materialit si dhe të prodhimeve të gatshme nuk paguhen veçanërisht.

1.2 Menaxher i Projektit (Inxhinieri)

Menaxher i projektit (Inxhinieri) është person i autorizuar nga Punëdhënësi të menaxhoj kontratën dhe të mbikqyrëkualitetin e materialeve , cilësinë e punimeve pranoj sasitë e realizuara , nënshkruaj ditarin e ndërtimit, librin ndërtimor , situatat dhe çertifikatat për pagesë.

1.3 Kontraktuesi

– Operatori Ekonomik i cili ka fituar tenderin për ' Sanimin e rrëshqitzës në Rrugën Hani i Elezit - Gorancë".

1.4 Shpenzimet e kontraktuesit për mobilizim dhe punime të përkoshme

Nuk do të ketë asnjë kompensim për sigurimin e transportit, dritën, energjinë, veglat dhe pajisjet,ose për furnizimin e godinës dhe mirëmbajtjen e impjanteve të ndërtimit, rrugëve të hyrjes, të komoditeteve sanitare, heqjen e mbeturinave, punën, furnizimin me ujë, mbrojtjen kundra zjarrit, si dhe struktura të tjera të përkohëshme, pajisje dhe materiale, ose për kujdesin mjekësor dhe mbrojtjen e shëndetit, ose për ndonjë shërbim tjetër, lehtësi, gjëra, ose materiale të nevojshme ose që kërkohen për zbatimin e punimeve në përputhje me atë që është parashikuar në Kontratë. Këto punime do të mbulohen me pozicionet e punëve për ndërtimin e mbikalimit .

1.5. Lejet për Punët

Kontraktuesi me shpenzimet e tij duhet të marrë lejet nga autoritetet relevante vendore. Lejet e tilla përfshijnë lejet për devijimin e komunikacionit, lejet rezidente dhe të punës, lejet për radio komunikime, lejet për vendosjen e nxjerrjes së gurëve dhe huazim të gropave, uzinave dhe strukturave sekundare të domosdoshme për përfundimin e punëve jashtë vendpunishtes.

Kontraktuesi duhet të arrij pajtueshmëri me kërkesat dhe duhet tu jap Autoriteve për dhënjen e lejeve mundësi të plota për të inspektuar dhe kontrolluar Punët apo për të pjesëmarrë në testimet dhe procedurat kontrolluese. Kjo nuk do ta liroj Kontraktuesin nga ndonjë përgjegjësi sipas Kontratës.

Asnjë veprim i rëndësishëm i ndonjë forme, në veqanti ndërprerja apo mbyllja e rrugëve ekzistuese, lidhjeve elektrike dhe të ujit apo ndonjë shërbimi tjetër komunal nuk guxon të behet pa miratimin me shkrim të Menaxherit të Projektit (Inxhinierit) . Kontraktuesi duhet të informoj Menaxherin e Projektit (Inxhinierin) në formen e shkruar me kohë dhe jo më vonë se shtatë ditë para fillimit të punëve të tilla në mënyrë që menaxheri i projektit (Inxhinieri) të aranzhoj mbikqyrje adekuate dhe paralajmërime për sigurinë.

1.6. Rregullimi i Komunikacionit

Kontraktuesi është përgjegjës për rregullimin e qarkullimit të komunikacionit në të gjitha rrugët publike të cilat mund të jenë në funksion gjatë zhvillimit të punëve ndërtimore. Kjo pjesë paraqet kërkesat specifike të Projektit për kontroll të komunikacionit rrugor përmes vendpunishtes, gjë që duhet të bëhet nga Kontraktuesi.



V.B

Kontraktuesi duhet të implementoj planin e Menaxhimit të Komunikacionit në përputhje me programin e përfshirë në Plan. Në baza ditore, Kontraktuesi duhet të siguroj se të gjitha masat lajmëruese për ridrejtimin e komunikacionit dhe kërkesat e sigurisë janë implemtentuar para fillimit të ndonjë punë relevante sipas Kontratës.

Kontraktuesi duhet të monitoroj efektshmerinë e vazhdueshme të Planit për Menaxhimin e Komunikacionit gjatë zhvillimit të Kontratës dhe duhet të përmirësoj dhe ripërtrijë Planin kur kjo është e domosdoshme.

Kur propozohet ndonjë ndryshim të aranzhimet ekzistuese të komunikacionit, Kontraktuesi nese urdhërohet nga Menaxheri i Projektit (Inxhinieri) duhet të përgatitë Planin për Menaxhimin e Komunikacionit i cili jep qartë në detaje aranzhimet e përmirësuara të komunikacionit në të gjitha lokacionet që ndikohen nga ndryshimi.

Plani i përmirësuar i Menaxhimit të Komunikacionit duhet ti dorëzohet Menaxherit të Projektit (Inxhinierit) për miratimin e tij së paku 7 ditë para datës së propozuar për ri-aranzhimin e komunikacionit.

Dështimi për tu përputhur me këto kërkesa mund të rezultoj që Inxhinieri të shtyj afatin për ri -aranzhimin e komunikacionit për të siguruar kohë të mjaftuehsme për njohtim të publikut. Një shtyrje e tillë nuk duhet të jetë shkak për vazhdimin e kohes sipas Kontratës. Nuk do të bëhet asnjë aranzhim komunikacioni derisa të miratohet nga ana e Menaxherit të Projektit Plani relevant për Menaxhimin e Komunikacionit.

1.7 Mjetet e kontrollit të Komunikacionit

Mjetet e kontrollit të komunikacionit duhet të jenë konform me gjitha Ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të aplikueshme në Kosovë dhe me kërkesat e Kontratës.

Të gjitha mjetet e kontrollit të komunikacionit duhet të mirëmbahen në kushte efektive dhe të pastërta deri sa hyn në punë sipas Kontratës. Mjetet që janë të dëmtuara apo të mveshura me tjetër gjë apo të cilat nuk janë konform me kërkesat e sipërme nuk duhet të shfrytëzohen. Shjenjat Portale të komunikacionit aty ku shfrytëzohen sipas Kontratës duhet të miratohen nga Inxhinieri.Vënia e mjeteve për kontrollin e komunikacionit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Kontratës përveq kur mjetet shtesë duhet të ofrohen dhe vendosen kur tregohen në vizatime apo kur kjo urdhërohet nga Menaxheri i Projektit (Inxhinieri).

1.8. Hyrjet për pasurinë private

Puna në kuadër të Kontratës duhet të kryhet në atë mënyrë ashtuqë hyrjet ekzistuese në pasuritë private që janë ndikuar nga punimet duhet të mirëmbahen në kushte të shfrytëzueshme gjatë tërë periodes së ndërtimeve. Kur kjo nuk është e mundur atehere duhet të behen aranzhime të tjera alternative të cilat janë të pranueshme për pronarët e pasurive që ndërlidhen në këtë çeshtje. Në këtë drejtim, Kontraktuesi duhet të lejoj dhe të ofroj për qarkullim të lirë të lëvizjes për hyrje dhe dalje në pasuritë private gjatë gjithë kohes përveq nese ndryshe pajtohet me pronarët e përfshirë të pasurive.

Kontraktuesi duhet që duke mos i shkaktuar shpenzime Punëdhënësit të riparoj ndonjë dëmtim në hyrje të pasurive private të cilat prishje janë si rezultat i veprimeve të Kontraktuesit në zhvillimin e punëve të parapara sipas Kontratës.

1.9 Bashkëpunimi me PK (Policia e Kosovës)

Nese duhet që personeli i policisë të jetë i pranishem për të ndihmuar dhe kontrolluar komunikacionin në vendin ku zhvillohen punimet dhe në rrethinen e tij atehere duhet që Kontraktuesi të bëj gjithë aranzhimet me Njesinë relevante të Policisë.

1.10. Lëvizjet e Këmbësorve

Atehere kur paraqitet domosdoshmeria e ofrimit të kalimit të këmbësorëve dhe të çiklistëve pranë apo përmes një pjese ku zhvillohen punimet sipas Kontratës atehere duhet që Kontraktuesi të ofroj rrugë kalime të përkohshme.



V.B

Kur një numër i madhë i këmbësorëve duhet të kaloj atehere duhet të merret parasysh që atyre tu ofrohet një kalim i përshtatshëm i cili edhe është i mbrojtur.

1.11.Kontrolluesi i Komunikacionit

Atehere kur duhet të shfrytëzohen, kontrolluesit e komunikacionit atehere një kontrollues i tillë duhet të pajiset me paisje portative dy kaheshe apo mjete tjera komunikimi në mënyrë që të sigurohet komunikacion i qetë dhe i sigurt. Mjetet e komunikimit duhet të jenë në kushte të mira të punës.

Kontrolluesit shtesë të komunikacionit duhet të shfrytëzohen atehere kur ka intensitet të madhë të komunikacionit dhe kur dukshmëria në komunikacion është e kufizuar. Kontrolluesit shtesë duhet gjithashtu të shfrytëzohen në situatat e tjera kur urdhërohet nga Menaxheri i projektit (Inxhinieri).

1.12.Përvijimi i korridoreve të komunikacionit

Shtyllat, cilindrat me shënjuesit në rast rreziku, shenjat reflektuese të përkohshme si dhe paisjet e tjera të skicimit duhet të shfrytëzohen si shtesë e kërkesave për mjetet e skicimit në Kontratë.

Shtyllat apo cilindrat që shfrytëzohen si lajmërim në komunikacion dhe/ ose kanalizimet duhet të ndërtohen ashtu që të kenë masë të vogël, të jenë fleksibile dhe elastike. Shtyllat apo cilindrat duhet të jenë minimum një meter të larta. Cilindrat duhet ta kenë diametrin së paku 500 mm pa marrë parasysh orientimin. Materialet nga çeliku nuk duhet të përdoren.Shënimet në shtylla apo cilindra duhet të behen me materiale të reflektueshme me gjerësi 100 mm deri në 150 mm. Secila shtyllë apo cilinder duhet të ketë të pakten dy shirita reflektiv.Shënjimet e përkohshme në shtresen shtruese si dhe materialet e shënimit duhet ta kenë miratimin e Inxhinierit. Mjetet e përkohshme të përcaktimit nuk duhet ta dëmtojnë siperfaqen punuese.

1.13. Drejtimi dhe shenjat e rrugëve

Në rastin kur bëhet ndryshimi i rrugëve dhe rrugëve anësore gjatë punëve ndërtimore atehere Kontraktuesi duhet të ofroj dhe të montoj shënja të tilla të domosdoshme për të ndihmuar në udhëtimin e publikut për të gjetur rrugët e tyre dhe për të mirëmbajtur qasje të sigurt në rrugë.

1.14. Inspektimi dhe shënimet

Kontraktuesi duhet të inspektoj të gjitha mjetet e kontrollit të komunikacionit dhe aranzhimet e kontrollit të komunikacionit çdo mengjes dhe pasdite për të siguruar se mjetet dhe aranzhimet e tilla kanë qenë adekuate. Kontraktuesi duhet të mbaj regjistrime për të gjitha ankesat e marra dhe veprimet që janë marrë për të zgjidhur ankesat e tilla. Regjistri i ankesave të tilla duhet ti ipet Menaxherit të Projektit me kërkesen e tij.

1.15. Menaxhimi i Mjedisit

1.15.1 Hyrje dhe Plani i Menaxhimit të Mjedisit

Kjo pjesë përshkruan kërkesat për ndikimet që ka menaxhimi i mjedisit gjatë zhvillimit të punëve ndërtimore. Elementet e Mjedisit duhet të përfshihen por jo të kufizohen në menaxhimin e kualitetit të ujit, Erozionin dhe sedimentacionin, trashigiminë kulturore, zhurmen, lëkundjet, kualitetin e ajrit, faunen vendore, vegjetacionin, menaxhimin e barërave të këqija, efektet vërshuese, vlerat vizuale, menaxhimin e mbeturinave, materialet e rrezikshme dhe token e kontaminuar.

1.15.2 Kualiteti i Ujit

Kontraktuesi duhet të siguroj se punimet ndërtimore nuk do të rezultojnë në prishjen e kualitetit të ujit ekzistues që vijnë nga burimet ujore në rrethinen e vendit ku zhvillohen punimet sipas Kontratës.



V.B

PMA(Plani i menagjimit të ambientit) duhet të përfshijë masat e sigurisë që duhet të ndërmirren për të parandaluar që punimet të ndikojnë në kualitetin e ujit nga burimet e ujit dhe sistemet natyrore të drenazhave. Aty ku është e zbatueshme plani duhet të përfshijë procedurat që duhet të implementohen kur është fjala për burimet e ujit për të lejuar nxjerrjen e e ujit.

Kontraktuesi duhet të parandaloj në zbrazjen e derivative, naftes, kemikaleve, ngjyrave, bitumenit, emulsioneve, herbicideve, detergjenteve apo materiet tjera të ngjajshme në burimet e ujit dhe formave të tjera të ujit.

1.15.3 Erozioni dhe kontrolli i sedimentacionit

Kontraktuesi duhet të ndërmerrë të gjitha paralajmerimet e arsyeshme për të parandaluar erozionin e dheut nga toka e shfrytëzuar, e zënë apo e ndikuar nga Kontraktuesi, erozioni i shtratit apo brigjeve të ndonjë prrocke apo lumi dhe deponimin e materialit të gërmuar apo të eroduar nga ndonjë burim uji, prrocke, liqeni apo rezervoareve të ujit që mund të jetë si rezultat i zhvillimin të punimeve.

Kontraktuesi duhet të përfshijë masat e Projektuara dhe teknikat për të kontrolluar erozionin dhe sedimentimin për të siguruar menaxhimin e ndikimit të kundert gjatë fazave të ndërtimit.

1.16 Trashigimia Kulturore

Nëse gjatë zhvillimit të punimeve , kontraktuesi hasë në objekte apo gjëra me rendësi historike dhe të ndonjë rëndësije domethënëse duhet të merret masa për ruajtjen e tyre dhe duhet të lajmërohen Autoritetet përkatës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore .

1.17 Zhurma

Kontraktuesi duhet të siguroj se zhurma nga vendi ku zhvillohen punimet të mos shkaktoj zhurmin të mjedisit. Nese ankesat që kanë të bëjnë me zhurmen merren atehere Punëdhënësi apo Inxhinieri mund të urdhëroj metoda të kontrollit të zhurmes të cilat duhet të implementohen. Asnjë pagesë shtesë nuk do ti bëhet Kontraktuesit nese ankesat merren për zhurmë ndaj mjedisit.

Nga ana e Kontraktuesit do të duhej të merreshin parasysh metodat në vazhdim për kontrollin e zhurmes si pjesë e programit për kontrollin e zhurmës. Kontraktuesi duhet të ofroj detajet në PMA. Zëvendësimin me procese alternative ,Qetësimin,Vendosjen e paisjeve (vendi, drejtimi dhe distance nga vendi i ndijshem ku bëhet zhurma e ndijshme),Mbylljet; dhe Ekzaminimi.

1.18 Dridhjet

Kontraktuesi duhet të ndërmerrë veprime të arsyeshme për të siguruar se punët ndërtimore nuk do të rezultojnë në dridhje që shkaktojnë dëme në rrethinen e vendpunishtes.Si udhërrëfim zona e ndikuar nga dridhjet mund të shkaktoj dëme të cilat definohen si në kuader të rrezes tri here në krahasim me distancen e paraqitur në tabelën në vijim :

Tabela Distanca e sigurisë së dridhjes

| Lloji i aktivitetit | • Distanca e sigurisë |
|---|---|
| Lëkundjet e fuqishme dridhëze | • 20 metra |
| Eksplodimi | • Kontraktuesi duhet të jap distancen bazuar në madhësinë e shpërthimit |



V.B

| | |
|---|---|
| Pile driving | • 60 metra |
| Të tjera | • Kontraktuesi të bëjë llogaritjen . |

1.19 Kualiteti i ajrit

Kontraktuesi duhet të ndërmerrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të siguruar se punët ndërtimore nuk do ndikojnë në prishje të kualitetit të ajrit në atë vend.Kontraktuesi duhet të siguroj se kualiteti i ajrit në vendpunishte dhe lokacionet e tjera që lidhen me punen përputhen me gjithë standardet relevante Evropiane .Nese ka ankesa për kualitetin e ajrit atehere Punëdhënësi dhe Inxhinieri mund të urdhërojnë që veprimet të ndërprehen derisa Kontraktuesi të kryej veprmet e nevojshme që emitimet e pluhurave mund të mbahen në nivel të kënaqshëm.

Të gjitha automjetet dhe vendpunishtja duhet të mbahen ashtu që të mbahet niveli i emetimeve deri në nivel të pranueshëm për Inxhinierin.

Pa marrë parasysh miratimet e tjera të marra nga Kotraktori, djegia e materialeve nuk duhet të lejohet pa pëlqimin e Inxhinierit. Atehere ku lejohet djegja e materialeve atehere mund të aplikohet kufizime shtesë nga ana e Inxhinierit. Djegia e gomave, naftes, produkteve të bitumenit dhe materialeve që krijojnë emetime toksike nuk do të lejohen assesi.

Masat e kontrollit për të zvogluar gjenerimin e pluhurit dhe për të parandaluar pluhurinë e gjeneruar nga puna sipas Kontratës nga personat e ndikuar apo rrethinen nga vendpunishtja duke përfshirë format në rrethinë duhet të ipen në PMA. Ato mund të përfshijnë por jo të kufizohen në:

- Lagien e rregullt të vendpunishtes dhe qasjeve në rrugë;
- Shmangien apo minimizimin e aktiviteteve që gjenerojnë pluhur ( p.sh heqjen, gërmimin etj) gjatë kushteve klimatike të thata dhe me erë.
- Paisjen e të gjitha paisjeve për bluarjen e gurëve me paisje që grumbullojnë pluhurinë;
- Stabilizimin e gjithë materialeve (duke përjashtuar materialet shtruese dhe shoshitjen) të rezervuara më gjatë se një muaj duke e vënë me barë apo me metoda të tjera të miratuara;
- Mbulimin e materialeve rezerve të më pak se 1 muaj më mbulesa plastike, gjeotekstilin, mjetet lidhëse sipërfaqësore etj.
- Sigurimin se paisjet ndërtimore të montuara në vendpunishte janë planifikuar dhe operojnë për të parandaluar emetimin e tymit, pluhurit, pluhurit të cementit dhe materiet tjera në atmosferë;
- Mbulimin e automjeteve që bartin materiale të cilat mund të gjenerojnë pluhur të tepruar dhe mbeturina; dhe
- Shpejt të largohen dhe pranohen materialet, balta, betoni apo derdhjet në siperfaqen e rrugës nga automjetet që transportojnë materiale për në dhe prej vendpunishtes të cilat mund të shkaktojnë telashe.

1.19.1 Flora dhe Fauna

Kontraktuesi duhet të minimizoj ndikimin e punimeve në dëmtimin e vegjetacionit dhe faunes. Kontraktuesi duhet që në PMM (Planin e menagjimit të Mjedisit )të përfshijë metodat për:

Kontrollin e mbajtjes së vegjetacionit të pastërt Të mbroj floren dhe faunen.

Nese aty ka patur ndonjë gjelbërim i cili duhet të merret dhe i cili mandej dëmtohet atehere punët riparuese duhet të behen me miratimin e Menaxherit të Projektit (Inxhinierit).

1.20. Punimet natën

Nëse Kontraktuesi dëshiron të punojë gjatë natës, ai do të dorëzoj detaje të plota të metodave të punës dhe ndriqimit, dhe qdo informacion tjetër Menaxheri i projektit ,mund ta ketë, dhe vetëm Menaxheri i projektit ka



V.B

të drejtë të mos japë apo të tërheq miratimin nëse, sipas mendimit të tij/saj, punë të tilla paraqesin rrezik apo shqetësim për pjesëmarrësit në komunikacion etj, ose për qfardo arsye me të cilën është i pakënaqur.

1.21. Ekzaminimet

Kontraktuesi do të kryej Ekzaminimet paraprake, vijuese dhe kontrolluese për nevojat e tij dhe për nevojat e Punëdhënësit në laboratorët e tij apo nga ndonjë kompani e rexhistruar për ekzaminime Laboraorike . Ekzaminimet kontrolluese duhet të kryhen nga Kontraktuesi nën mbikqyrjen e menaxherit të projektit (inxhinierit) . Kontratktuesi është i obliguar që të siguroj certifikata e cilësisë , për materialet e përdorura dhe të njatat në dy kopje ti dorëzoj Menaxherit të Projektit .

Kontraktuesi i mbulon të gjitha shpenzimet për të gjitha testet e specifikuara (paraprake, vijuese dhe kontrolluese ) në kuadër të vlerave të kuotuara të çmimeve njësisi të punëve të kontraktuara . Nuk do të ketë pagesë shtesë kontraktuesin për testimet. Numri i testimeve, për material, pajisje dhe testimet për punët e realizuara , sipas pozicioneve duhet të jetë në përputhje me Standardet teknike sipas llojit të punimeve . Të gjitha Raportet e testimeve me rezultatet e fituara duhet të punohen në 5 kopje të shtypura (origjinal). Dy kopje i mban kontraktuesi i punimeve , një kopje Laboratori i cili ka kryer e ekzaminimet , dy kopje i dorëzohen Menaxherit të projektit (përfaqsues i Punëdhënësit për mbikëqyrjen e punimeve) .

Kontraktuesi vë në dispozicion të Menaxherit të Projektit të gjitha rezultatet e testimeve dhe datat e këtyre testimeve në kuader të fushëpërfshirjes dhe formes së kërkuar. Kontraktuesi duhet ti ofroj Menaxherit të Projektit dy kopje të rezultateve të testimeve brenda 24 orësh nga koha e kryerjes së secilit testim.

Punëdhënësi mund të angazhoj Laborator të veçant për shqyrtime kontrolluese dhe mund në çdo kohë me kërkesen e Menaxherit të projektit (Inxhinierit) ose sipas Kushteve të përcaktuara në Kontratë, të kërkoj të bëhen shqyrtime Kontrolluese plotësuese. Pagesa për shqyrtime kontrolluese pë laborator të angazhuar nga Punëdhënsi do të bëhet nga Punëdhënësi.

1.22. Pranimi i Punëve

1.22.1 Pranimi i përkohshëm

Në fund të cdo muaji, Menaxheri i Projektit (Inxhinieri) së bashku me Kontraktuesin do të përcaktojnë vëllimin e punës së kryer gjatë muajit, cilësia e së cilës duhet të përputhet me cilësinë e përshkruar me Kushtet Teknike. Pagesa mujore do të kryhet në bazë të sasisë së punës të pranuar nga Menaxheri i Projektit.

Menaxheri i projektit do të lëshojë një Qertifikatë të Pranimit të Punës, ose një deklaratë që tregon se punët nuk janë të pranueshme, me komentet e tij/saj dhe arsyet për refuzim të shprehura qartë, dhe do të informojë Kontraktuesin për këtë duke i dërguar një kopje

1.22.2 Pranimi Final i punëve

Kontraktuesi do të informoj Projekt Menaxherin për datën kur pritet të përfundojnë të gjitha punimet jo më vonë se 7 ditë pune përpara asaj date. Menaxheri i Projektit do të caktojë me Kontraktuesin datën kur do të bëhet procedura e pranimit. Do të vërtetohet se a janë kryer punët apo jo, apo do të dëshmohet (në rast nevoje) se punët janë përfunduar me defekte. Menaxheri i projektit do të përpiloj një raport i cili duhet të jetë i nënshkruar nga të dy palët (Projekt Menaxheri dhe Kontraktuesi).

Nëse Kontraktuesi refuzon të nënshkruajë, ky refuzim do të përfshihet në raport.

1.22.3 Pranimi teknik

Pas pranimit të punëve nga Menaxheri , Kontraktuesi eshte i obliguar të kërkoje nga Punëdhënësi formimin e komisionit per pranimin teknik te puneve te kryera.Kërkesa për pranim teknik duhet të miratohet nga Menaxheri i Projektit ( Organit mbikqyrës).

1.22.4 Ditari i Punëve



VB

Kontraktuesi duhet të ketë ditarin e punëve për Projekt Menaxherin, ku do të regjistrojë të gjitha vërejtjet dhe sygjerimet lidhur me ecurinë e punimeve në punishte:

- Dinamikën e punimeve dhe personelin punues
- Numrin dhe llojin e pajisjeve/bazave qofshin ato në gjendje pune apo jo
- Përshkrimi I pozicioneve që realizohen – në baza ditore .
- Kushtet atmosferike (moti).
- Fuqinë punëtore të angazhuar për realizimin e punimeve .
- Ditari duhet të mbahet në punishte . Menaxheri i Projektit në çdo kohë mund të kërkojë ditarin e ndërtimit dhe të ep komentet dhe vërejtjt me shkrim në ditar.Ditari ndërtimor duhet të nënshkruhet nga Udhëheqësi i punishtes dhe Menaxheri i Projektit (organi mbikqyrës).

1.22.5 Libri i ndërtimit

Kontraktuesi duhet të ketë Librin ndërtimor (libri i sasive ) , në cilin duhet të evidentohen , sasitë faktike të realizuara në teren . Libri ndërtimor duhet të nënshkruhet nga Udhëheqësi i punishtes dhe Menaxheri i projektit (organi mbikqyrës).

1.23 Foto dokumentacioni gjatë ndërtimit

Kontraktuesi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demostruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve. Detalet e nevojshme gjatë zhvillimit të punimeve . Nuk do të bëhen pagesa për foto dokumentacion. Foto dokumentacioni do të bëhet në kopje të mjaftueshme dhe një kopje do ti dorëzohet Menaxherit të projektit . Foto dokumentacioni do të jetë pjesë e dokumentacionit të zbatimit të kontratës .

1.24 Projekti i gjendjes së ekzekutuar

Gjatë zbatimit të punimeve në punishte ,kontraktuesi do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e "Vizatimeve siç është zbatuar". Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar, material i cili do të jetë i disponueshëm në çdo kohë gjatë zbatimit për Menaxherin e Projektit. Këto vizatime do të azhornohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t'i dorëzohen Mbikëqyrësit të Punimeve çdo muaj për aprovim, pasi Punimet të kenë përfunduar.

Projekti i gjendjes së ekzekutuar duhet të punohet në tri kopje dhe në CD. Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve, "siç është zbatuar" do t'i dorëzohen Mbikqyrësit të Punimeve për aprovim. Vizatimet, "siç është zbatuar", të aprovuara, do të bëhen pronë e Punëdhënësit .

II : PËRSHKRIMI I PUNËVE ME KUSHTET TEKNIKE

Punimet do të realizohen sipas Standardeve dhe përshkrimeve të punëve me kushtet teknike të dhëna në" Projektin zbatues për Sanimin e rrëshqitzës në Rrugën Hani i Elezit-Gorancë".

- Sigurimi i kualitetit të materialve dhe cilësisë së punimeve
- Testimet e materialëve dhe cilësisë së punimeve nga betoni duhet të bëhen sipas Normave të përcaktuara në kushtet teknike në Standardet për Rrugë dhe ura , Normave Europiane EUROCOD (strukturat ) e standardeve Amerikane AASHTO .
- Sigurimin e kualitetit të materialeve dhe cilësisë së punimeve mund të bëhen edhe sipas Normave dhe standardeve teknike Kroate (Libri 1-6).

1. Kushtet e përgjithshme

Qëllimi i prezantimit të kushteve të përgjithshme është që të sigurohet kryerja kualitative e punimeve dhe në pajtim me rregullat dhe standardet teknike.

Për këtë arësye edhe punëkryesi është i obliguar që ti përmbahet me përpikëri aplikimit të rregullave dhe standardeve teknike gjatë realizimit të punimeve që janë lëndë e këtij projekti si dhe udhëzimeve të organit mbikqyrës.



V.B

Në bazë të rezultateve të fituara nga hulumtimet paraprake gjeodezike,gjeofizike dhe gjeologo-gjeoteknike i zonës të cilës ka pësuar rrëshqitje ,kompania projektuese ka ofruar zgjidhjen per stabilizimin e pjerrtësisë perkatesisht trasesë së rruges.

1.1.1 Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe largimi i instalimeve ne punishte

Kontraktori prej momentit te nenshkrimit te kontrates deri ne fillimin e punimeve duhet qe te pergaditet per mobilizim ne punishte ne menyre qe te jete operacional gjate tere kohes se ekzekutimit te punimeve.
Fillimisht Kontraktori duhet qe te pergadise projektin e organizimit te kantierit per pune administrative dhe menaxheriale duhet qe ti kete objektet percjellese hapesirat per laborator mobil si dhe hapesiren per mbajtjen e takimeve me investitorin dhe organin udheheqes.Gjithashtu ne punishte kontraktori duhet te kete edhe hapesiren per dhenjen e ndihmes se pare punetoreve ne rast se vjen deri te ndonje lendim si dhe WC mobile qe duhet te mirembahen gjate tere kohes se ekzekutimit te punimeve.

Mekanizimi i parapare per kryerjen e punimeve dhe organizimi dhe teknologjia e sanimit të rrëshqitzës duhet te jete ne pershtateshmeri te plotë me natyren e punimeve qe duhet te kryhen ndersa planet dinamike duhet ta percaktiojn sakte kohen e fillimit dhe perfundimit te secilit aktivitet dhe resurset qe duhet te angazhohen per te.

Organi udheheqes ka te drejte te kerkoj modifikime te caktuara ne projekt te organizimit te kantierit ose ne planet dinamike nese ato nuk jane adekuate me natyren e projektit ne fjale.

Pagesa per kete pozicion behet ne paushall dhe vleresimi i paushallit duhet te behet ne baze te progresit te kontraktorit per kompletimin e ketij pozicioni.

1.1.2 Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjës së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve

Fillimisht ne fazen e pergaditjes se punishtes dhe trases Kontraktori eshte i obliguar qe te vendos shenjat e nevojshme per kontrolle dhe orientim te trafikut ne menyre qe trafiku te rrjedhe i panderprere gjate tere kohes se ekzekutimit te punimeve.

Gjtithashtu duhet te vendosen edhe shenjat adekuate te lajmerimit per punime ne rruge ne distanca adekuate ne fillim dhe ne perfundim te trases si dhe pergjat trases.

Para se te vendosen keto shenja Kontraktori eshte i obliguar ta pergadise nje projekt adekuate te sinjalizimit qe paraprakisht duhet te aprovohet nga organi mbikqyres, organi udheheqes ka te drejte te kerkoj modifikime te caktuara ne projekt te cilat Kontraktori eshte i obliguar ti plotesoj.

1.1.3 Vendosja e dhe sigurimi I pikave te reja poligonale per percjellje te puneve gjeodezike ne teren

Ky pozicion përfshin:

- mbikëqyrjen e pikave treguse(poligonale) që tregojnë shtrirjen e rrugës dhe të objekteve tjera në rrugë.
- Të gjitha masat e nevojshme për barrtjen e të dhënave prej projektit në terren apo prej terrenit në plan dhe
- Mirëmbajtjen e shenjave të vendosura në terren gjatë gjithë kohës,prej fillimit të punëve deri tek pranim-dorëzimi I të gjitha punëve nga punëdhënësi.

Kjo punë përfshinë gjithashtu edhe pranim-dorëzimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha drafteve themelore të studimit dhe të planeve dhe shenjave të vendosura në terren,të cilat punëdhënësi ia dorëzon kontraktorit në fillim të punëve.

Shtrirja e këtyre punëve duhet në tërësi ti plotësojë nevojat e ndërtimit,kontrollimin e punëve,vlerësimin e harxhimeve,dhe të faktorëve tjerë,të cilët I krijojnë kushtet për ekzekutimin e punëve.

Punët gjeodezike përfshinë gjithashtu edhe prodhimin e planeve ekzekutive e pikave poligonale (të shtririjes ) së rrugës që do të ndërtohet dhe/apo të objekteve tjera.Planet ekzekutive duhet të prodhohen përpara inspektimit teknik të rrugës së ndërtuar dhe/apo të objektit.



V.B

1.2.1.1. Pastrimi i Terenit

1.2.1 Përshkrimi

1.2.1.1 Prerja dhe largimi I shkurreve dhe drunjeve me diameter deri 50 cm, ne te dy anet e rruges
Këto punë përfshinjë :
-prerija dhe largimi I drunjëve me diametër të trungut deri në 15 cm ,prerja dhe largimi I drunjëve me diametër të trungut prej 15 cm deri 50 cm dhe të atyre me diametër mbi 50 cm,largimi I degëve të drunjëve më parë të prerë dhe largimi I trungjeve të drunjëve të drunjëve të vjetër dhe drunjëve të prerë kohëve të fundit me diametër prej 15 cm deri në 50 cm dhe të atyre me diametër mbi 50 cm.
-pastrimi dhe gërmimi I sipërfaqeve,që përfshijnë prerjen dhe largimin e shkurreve,degëve dhe drunjëve,çrrënjosja e trungjeve të drunjëve dhe të rrënjëve,ndarja e trungut të drurit nga dheu,largimi I materialeve organike që kanë mundur të mbesin gjatë largimit të shkurreve,drunjëve,degëve dhe trungjeve dhe transportimi I tyre në një lokacion të specifikuar që gjindet jashta shtrirjes së trupit të rrugës.

Sipërfaqja që duhet të pastrohet dhe/apo të gërmohet duhet të tregohet në plane apo sipërfaqja duhet të përcaktohet nga ana e inxhinjerit mbikëqyrës përpara se të fillojnë punët.

---

1.2 Punimet Tokesore

1.3.1 Germimi i dheut te kategorise III– IV dhe V-VI të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi min 10km.

1.3.1.1 Përshkrimi
Gërmimi përfshinë:

- Heqjen e shtresës humusore deri në trashësinë e kërkuar (jo më tepër se 40 cm në thellësi), duke e përfshirë edhe vendosjen anash dhe/ose transportin derin në deponi;
- Gërmimin e gjërë të të gjitha kategorive të dheut dhe të gurit, ashtu siq' parashifet me projekt, përfshirë bartjen e materialit anash dhe/ose transportin e materialit deri në deponi, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve të gërmuara në mbushje, mbushje skajore të urave, mbushje të prapme të urave, agregat të thyer për konstruksione, dhe/ose për deponi, sipas mënyrës se si do të përdoret ky material gjatë punëve.Kjo punë duhet ta përfshijë edhe gërmimin e kërkuar për kaskada, gërmimin për profilime të ndryshme, vendet ku huazohet materiali dhe operacionet e ngjajshmepër devijimet e drejtimeve të rrugëve dhe të lumejve, dhe të gjitha gërmimet e gjëra për ndërtimin e strukturave;
- Të gjitha gërmimet e kërkuara për fundime të strukturave dhe për shërbime të llojeve të tjera, dhe kanalet tjera (lëshesat, pusetat, drenazha), të të gjitha kategoritë e materialit deri në qfarëdo thellësie:
  - 1.0 m gjërësi, dhe
  - 1.0 deri në 2.0 m gjërësi

Kjo punë duhet poashtu ti përfshijë të gjitha operacionet të cilat nevoiten për gërmimin e materialeve të tepërta të ngriten deri në një nivel të caktuar:

- të gjitha gërmimet e thella për strukturat më tepër se 2.0 m gjërësi, të të gjitha kategorive të materialeve dhe deri në qfarëdo thellësie, duke e përfshirë bartjen e materialit deri në deponi ose deri në lokacionet në të cilat materiali do të vendoset në mbushje të ndryshme, mbushje të prapme dhe agregat të thyer për konstruksione. Kjo punë duhet ta përfshijë edhe ngritjen e materialit deri në një nivel të caktuar;
- Të gjitha gërmimet për kanalet për tharjen ose bonifikimit e dheut dhe për rregullimin e shtrateve të lumejve dhe punë të tjera të ngjajshme në të gjitha kategoritë e dheut dhe gurit me thellësi dhe gjërësi të ndryshme. Poashtu në vistrën e këtyre punëve duhet të përfshihet edhe thellimi dhe zgjërimi I kanaleve ekzistuese;
- Të gjitha gërmimet e kanaleve të drenazhës dhe kanalet tjera bër bartjen e ujit përgjatë strukturës së rrugës, nënshtresë (posteljica, subgrade) e rrugës ekzistuese, duke përfshirë edhe bartjen e materialeve anash ose/edhe transportin deri në deponi;
- Të gjitha gërmimet për mveshjet me pllaka dhe për mveshje me gurë në sipërfaqet e caktuara me projekt për mveshje me gurë përfshirë edhe gërmimin dhe bartjen ansh ose/ehde transportin deri në deponi dhe punimi I planumit.
- Gërmimi duhet të jetë me prerje tërthore siç kërkohet me projekt me dukje dhe pjerrësi të siç kërkohet me projekt ose sipas kërkesave të inxhinierit mbikëqyrës.



V.B

- Gjatë punëve të gërmimit, te gjitha të dhënat nga Regulativa e sigurisë në punë duhet të respektohen (vendosja e shtyllave, stabilizimi I pjesëve vertikale dhe të pjerrëta prerja e rrafsheve dhe masa të tilla të ngjajshme); strukturat ekzistuese, vijat e komunikacionit dhe mjetet tjera duhet të mbrohen, dhe mirëmbajtja rutinore e sipërfaqeve publike dhe qasjet në rrugë që do të përdoren duhet të sigurohen.
- Në rast të rrezikut nga rrëshqitja e dheut ose të depresioneve të ndryshme, puna duhet të kryhet në shkallë, që të ëvitohet rreziku nga akcidentet e tilla, ose duhet të sigurohet mbështetje adekuate, posaqërishtë nëse është fjala për lartësi më të mëdha,
- Kur përdoret eksplozivi për qëllime të gërmimit, kontraktori duhet të punësojë punërorë me trajnime dhe kualifikime adekuate. Gjatë punëve me ekplozive ose gërmimeve, qfarëdo pengese për trafik, për njerëzit përreth dhe për vet rrethinën të cilat mund të dalin nga puna e tillë, duhet të redukohet deri në minimum, dhe duhet të sigurohen shenja përkatëse për sigurinë e trafikut si dhe sisteme të caktuara të signalizimit. Nëse, lajmërohet qfarëdo pengese, duhet të eliminohet menjëherë nga kontraktori I cili duhet t'I mbulojë të gjitha shpenzimet. Nëse metoda e minimit e aplikuar nga kontraktori shkakton ndonjë dëm të masivit shkëmborë, kontraktori duhet ta riparojë dëmin dhe shpenzimet për riparimet e tilla duhet ti mbulojë vet kontraktori.

1.3.2 Formesimi dhe ngjeshja e nënbazes se trupit te rruges me ngjeshmeri 30 MN/m2

Pas kompletimit të operacioneve te rrafshimit dhe përzierjes, nënshtresat ezisteuse të dheut dhe dherat e përmirësuar dhe/ose të stabilizuar në nështresa të dheut duhet të kompaktohen përgjatë tërë gjërësisë të shtresës së dheut duke përdorur cilindra me rrotë të lëmuara apo me rrotë pneumatike. Vendet në të cilat cilindri nuk ka qasje duhet të kompaktohen sipas projektit duke përdorur mjete dhe operacione të tjera për kompaktim të cilat duhet të aprovohen nga inxhinieri mbikëqyrës I cili poashtu duhet t'I përcaktojë kushtet sipas të cilave duhet të përdoren këto mjetë dhe të kryhen këto operacione. Para qfarëdo operacioni të kompaktimit, duhet të testohet përshtatshmëria e tyre për përdorim sipas Kushteve të Përgjithshme Teknike.

Para fillimit të kompaktimit, nënshtresa e dheut ekzistues, nënshtresa e përmirësuar dhe/ose përzierja e stabilizuar duhet të përmbajnë aq ujë sa të mund të kryhet kompaktimi adekuat. Nëse ka nevojë, Inxhinieri mbikëqyrës mund të caktojë procedura plotësuese, të cilat do të sigurojnë përbërjë adekuate të lagështisë dhe vendosje adekuate të dheut, shkëmbit dhe/ose të përzierjes. Kur, pas operacionit të kompaktimit dhe pas testimeve të kualitetit të planumit të shtratit të rrugës, mbushja, mbushja e prapme dhe vendosja e agregatit të thyer nuk kryhen menjëherë, por pas ndonjë periudhe të gjatë dhe në kushte të ndryshueshme klimatike, para përfundimit të punëve, duhet të verifikohet edhe njëherë shkalla e kompaktimit të nënshtresës së planumit. Punët mund të përmbyllen nëse kualiteti tregohet si konform kërkesave.

**1.4.3.1** Perdorimi I gjeotekstilit per seperim dhe filterim.
Gjeotekstili duhet te shfrytezohet si separator te nenbazes dhe bazes granulare te trupit te rruges, Funsioni kryesor I gjetekstilit duhet te jete seperimi I ketyre dy shtresave si dhe filtrimi ujit nga shtresat e siperme te trupit te rruges deri ne drenazhe.

*1.4.3.2 Vendosja*
Gjeotekstilet duhet te jene te mbrojtura gjate tere kohes ndaj demtimeve kimike dhe mekanike. Te gjitha pjeset e materialeve qe mund ta demtojn siperfaqen e gjeotekstilit duhet qe te largohen nga trupi I rruges.

Gjeotekstili duhet te shtrihet ne tere gjersin e trupit te rruges te parapare ne projekte dhe duhet qe strict te ju permbahet udhezimeve te prodhuesit per vendosje.

Gjetekstili duhet te shtrihet ne momentin kur te ngjeshen dhe pranohen shtresat stabilizuese te trupit te rruges dhe para se te fillohet te vendosen shtresat granulare te trupit te rruges. Ekspozimi ndaj kushteve atmosferike duhet te jete sa me I shkurter I mundeshem.

